

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe
Ekonomisë së Ujërave
Trupi për menaxhim me
IPARD

IPARD Program 2014-2020



Masa 1

INVESTIME NË MJETET THEMELORE
TË EKONOMIVE BUJQËSORE

# MUNDËSI EVROPIANE PËR BUJQËSINË MAQEDONASE DHE ZHVILLIM RURAL

www.ipard.gov.mk, www.ipardpa.gov.mk


Instrument për asistencë të para pranimit për zhvillim rural - IPARD 2014 - 2020
Këtë projekt e zbaton Organi për Udhëheqje me IPARD
rr. Aminta III, nr. 2, Shkup
Financuar nga: Masa Ndihmesë Teknike nga IPARD Programi 2014-2020


IPARD
EU4Rural Areas



## I Shfrytëzues

### 1. Ekonomia bujqësore
- Person fizik (bartësi i ekonomisë bujqësore familjare);
- Bujk individual – BI;
- Person juridik.

### 2. Kooperativat

## II. Kapacitete prodhuese me të cilat duhet të disponojë kërkuesi:
**Prodhimtari bimore**
- Minimum **0,1 he** për investime në **fidanishte**;
- Minimum **0,3 ha** për investime në **kultura shumëvjeçare dhe sera;**
- Minimum **0,5 he** për investime në **prodhime të kopshtarisë në sipërfaqe të hapur;**
- Minimumi **1 ha** për investime në **drithëra, kultura industriale dhe kultura foragjere;**
- Minimumi **1 ha** në rast të investimit në **makineri bujqësore.**

**Prodhimtari blegtorale**
- **5 lopë/12 viça** për investime në **gjedhe qumështi;**
- **15 dele/dhi** për investime në **kultivimin e dhenve/dhive;**
- **16 dosa/300 derra** për investime në **derrëtari;**
- **1 400 zogj pule/700 pula** për vezë për investime në **shpendari** (duke përjashtuar rosat, patat, gjelat e detit, fazanët, strucat dhe pulat afrikane).

*Në prodhimtarinë blegtorale kapaciteti i kërkuar duhet të arrihet në fund të investimit.*

## III. Standarde

**Në fund të** investimit duhet të arrihen standardet nacionale minimale për:
- **Shëndet publik** (në prodhimin e qumështit dhe përpunimin e ekonomive bujqësore)
- **Mirëqenie të kafshëve** (në prodhimin blegtoral dhe përpunimin e ekonomive bujqësore gjatë therrjes së kafshëve shtëpiake)
- **Mbrojtje të mjedisit jetësor.**



## IV. Qëndrueshmëri ekonomike

Qëndrueshmërinë ekonomike të investimit kërkuesi e dëshmon nëpërmjet:
- **Propozim-projektit teknik** (për investime deri **në 50.000 €**);
- **Planit të biznesit** (për investime **mbi 50.000 €** dhe kur kërkues është kooperativë bujqësore)

## V. Pronësia e tokës

Për tokën dhe/ose objektet që janë lëndë e investimit kërkuesi duhet të dëshmojë:
- **Pronësinë;**
- **Marrëveshjen për marrje me qira** (më së paku 7 vjet nga dita e dorëzimit të kërkesës).

## VI. Kritere specifike

- investimet për **ujitje** jane të dedikuara per vendosje te reja dhe përmiresime te reja, ndërtimin e sistemit mbi ato ekzistuese per ujitje.
- Investimet në vendosjen/modernizimin e **serave me qelq dhe serave me plastmase** (mbështjellësit tradicional (tunelet) nuk janë të pranueshëm);
- **Vreshtat/material për mbjelljen e hardhisë** – të jenë në pajtim me Listën Nacionale të Llojeve ose me Katalogun e përgjithshëm të llojeve të verës dhe të llojeve të hardhisë së rrushit të verës dhe bazat e BE-së;
- **Hardhitë e rrushit** – të jenë të regjistruara në Regjistrin nacional të hardhive të rrushit;
- **Fermat e kafshëve shtëpiake** në fund të investimit të sigurojnë hapësirë dhe pajisje për kultivim;
- **Investimet në prodhimtarinë blegtoriale,** duhet të dëshmojnë se objektet janë të siguruara ose të propozojnë investime në sistemet për menaxhimin e plehut organik;
- Investimet për **prodhimin e energjisë nga burime të rigjenerueshme** – vetëm për përmbushjen e nevojave personale të ekonomive bujqësore;
- Kërkuesit që merren me **derrëtari/shpendari intensive**, mund të propozojnë investime për themelimin e kërkesave të integruara ekologjike.

## VII. Sektorët prioritar

**Prodhimtaria bimore**
Drithëra, kultura industriale, kultura foragjere, kopshtari (përfshirë patatet), kulturat shumëvjeçare (pemishte, përfshirë rrushin e tryezës, ullinjtë, pemët e mjaltit për prodhimin e mjaltit), vreshtat.

**Prodhimtaria blegtorale**
Gjedhëtari (gjedhe qumështi, majmëri), derrëtaria (riprodhim, majmëri), dhentari dhe kultivimi i dhive (dhentari dhe kultivim i dhive të qumështit, majmëri), shpendari (prodhimi i mishit – zogu i pulës, pula për vezë).

**Përpunimi dhe marketingu i drejtpërdrejtë i prodhimtarisë bujqësore personale të ekonomive bujqësore**
Qumështi dhe produktet e qumështit, mishi dhe produktet e mishit, frutat dhe perimet duke përfshirë edhe patate, kërpudha dhe kultura të bishtajoreve, drithëra, produkte të mullirit dhe produkte të niseshtes, vajra dhe yndyrëra me origjinë bimore dhe shtazore, musht rrushi, lëng rrushi, verë dhe uthull, shtohet, edhe ushqim për kafshët dhe kulturat foragjere.

**Prodhimi i energjisë nga burime të rigjenerueshme për konsum personal**
Përpunimi i produkteve bimore dhe shtazore nga biomasa primare dhe sekondare (përveç biomasës të produkteve të peshkut) për prodhimin e biogazit dhe/ose biokarburanteve, shfrytëzim i energjisë diellore, aerogjeneratorëve, energjisë gjeotermale, etj.



**Investimet e ardhshme**
Një kërkues gjatë periudhës së zbatimit të Programit, mund të dorëzojë më tepër projekte në kuadër të kësaj mase, me kusht që shpenzimet e pranueshme dhe të përgjithshme maksimale (deri në 1.500.000 €) të mos tejkalohen dhe projektet e mëparshme të realizohen (t'i paguhen shfrytëzuesit).

## VIII. Investime të pranueshme

- Konstruimi/rikonstruimi i objekteve për prodhimtari ose objekteve ndihmëse;
- Konstruimi/rikonstruimi i objekteve që shfrytëzohen për aktivitete që përdoren pas korrjes dhe përpunimi i produkteve bujqësore;
- Furnizimi i bimëve shumëvjeçare;
- Furnizimi i makinerive dhe pajisjeve të reja;
- Objekte dhe pajisje për ujitje;
- Furnizimi i rimorkiove të specializuara të transportit;
- Infrastruktura e ekonomive bujqësore.



## IX. Lartësia e mbështetjes

Lartësia e mbështetjes financiare është **60%** nga shpenzimet e përgjithshme dhe të pranueshme të investimit.
Lartësia e mbështetjes financiare do të zmadhohet deri në:

- **65%** për investime në ekonomitë bujqësore të realizuara nga bujqit e rinj;
- **70%** për investime në ekonomitë bujqësore në zonat malore.

Mbështetja financiare do të zmadhohet për **10 %** për:
- Investime që kanë të bëjnë me sistemet e ruajtjes dhe menaxhimit të plehut organik;
- Investime për përmirësimin e efikasitetit gjatë përdorimit të plehrave të azotit dhe ngjashëm;
- Investime në objekte/pajisje për përmirësimin e efikasitetit energjetik;
- Investime në objekte/pajisje për prodhimin e bio-energjisë;
- Investime në objekte/pajisje për prodhimin e energjisë nga burime të tjera të rigjenerueshme për përmbushjen e nevojave personale për energji në ekonomitë bujqësore;
- Investime në objekte/pajisje për trajtimin e ujërave të zeza/kanalizimeve.

Vlera minimale e shpenzimeve të përgjithshme dhe të pranueshme për një projekt investues – **3.000 €.**

Vlera maksimale e shpenzimeve të përgjithshme dhe të pranueshme për një shfrytëzues është **1.500.000 €** gjatë tërë periudhës së zbatimit të Programit.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe
Ekonomisë së Ujërave
Trupi për menaxhim me
IPARD

**Formularët e nevojshëm për aplikim mund të merren në:**

**Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave**
Tel.: 02/3134-477 lokali 113,114,115, Sektori IPARD
Adresa: Aminta III nr.2, Shkup,
**www.ipard.gov.mk**

**Agjensionin për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**
Tel.: 02/3097-460
Adresa: Brigada e III-të Maqedonase p.n., Shkup
**www.ipardpa.gov.mk**

**Agjensionin për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë**
Tel.: 047/228-330 dhe 047/228-370
Adresa: Kliment Ohridski, Manastir
**www.agencija.gov.mk**

**www.ipard.gov.mk, www.ipardpa.gov.mk**

IPARD EU4Rural Areas
Instrument për asistencë të para pranimit për zhvillim rural - IPARD 2014 - 2020
Këtë projekt e zbaton Organi për Udhëheqje me IPARD
rr. Aminta III, nr. 2, Shkup
Financuar nga: Masa Ndihmesë Teknike nga IPARD Programi 2014-2020